



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 29.07.2019

Ref.: 1366/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet Kolegji i Shkencave Mjekësore Rezonanca në nivelin institucional, për periudhën 3 vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022.
- II. Akreditoohen programet e studimit për periudhën 3 vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022.
 - Mami, BSc 180, ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik;
 - Radiologji Diagnostike, BSc, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
 - Biokimi Laboratorike, BSc, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
 - Farmaci, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- III. Akreditohet programi i studimit për periudhën 5 vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2024.
 - Infermieri, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik;
- IV. Obligohet Kolegji i Shkencave Mjekësore Rezonanca që deri me datë 1 Tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Kolegji i Shkencave Mjekësore Rezonanca ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për Akreditim institucional dhe të programeve të studimit:


AKA ka organizuar vizitën me 5 qershor dhe 21 qershor 2019, me qëllim të vlerësimit të institucionit dhe të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, me këtë përbërje: Prof. Dr. Melita Kovacevic, Prof. Dr. Danica Zeleznik, Prof. Dr. Zdravko Lackovic, Ms. Delia Gologan

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19 qershor 2019 dhe 15 korrik 2019 ka shqyrtuar raportin final të ekspertëve ndërkombëtar për Kolegjin e Shkencave Mjekësore Rezonanca, dhe pas shqyrtimit të rekomandimeve përfundimtare, të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji i Shkencave Mjekësore Rezonanca
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë